



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 550/13 prot.

Tiranë më 19.04.2018

**REKOMANDIM**

Nr. 17, datë 19.04.2018

**PËR KONTROLLUESIN Hotel "The Plaza Tirana sh.a."**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 31 pika 1, gërma a/1 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Hotel "The Plaza Tirana sh.a.",

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit Nr.108 datë 23.03.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Hotel "The Plaza Tirana sh.a.", me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Hotel "The Plaza Tirana sh.a.",

Në funksion të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Shoqëritë që ushtrojnë aktivitetet në fushën e hotelerisë, janë kontrollues të cilët mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale të kategorive "punonjës" dhe "klientë".

Kontrolluesi Hotel "The Plaza Tirana sh.a." është subjekt juridik me NIPT: L51930016U dhe ka objekt aktiviteti "... Menaxhim i hoteleve..., hapje dhe menaxhim të sallave të konferencave..., menaxhim i bareve dhe restoranteve, menaxhim të qendrave të rekreacionit, trajtim të lëkurës, masazhe, SPA etj..".

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi, sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim në datë 11.04.2018, u konstatua se:

1. Kontrolluesi ka "Njoftuar" pranë Zyrës së Komisionerit, mbi përpunimin e të dhënave personale në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit, menjëherë sapo ka filluar aktivitetin në vitin 2016.
2. Kontrolluesi ka hartuar rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
3. Kontrolluesi ka nënshkruar "*Deklaratë Konfidencialiteti*" me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale.
4. Kontrolluesi ka kontraktuar subjekte të tjera me qëllim sigurinë fizike të ambienteve (në të cilën përfshihet administrimi dhe mbikëqyrja e ambienteve nëpërmjet sistemit të video-survejjimit CCTV), krijimin dhe mirëmbajtjen e sistemit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore etj. Në kontratat respektive janë parashikuar kushte dhe kritere për ruajtjen e konfidencialitetit si dhe udhëzime për përpunimin e të dhënave.
5. Kontrolluesi mbikëqyr ambiente të brendshme dhe të jashtme të objektit në të cilin ushtron aktivitetin nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit CCTV. Sistemi është i përbërë nga kamera të thjeshta dhe cilësore (4K) të tipeve të ndryshme si të jashtme, të brendshme, dome 360<sup>0</sup> etj. Ambientet e mbikëqyrura janë perimetri i objektit (deri në distanca mbi 300m vijë ajrore), koridoret, restorantet, baret, kuzhina, recepsioni, hyrja dhe koridori i ambienteve të SPA-së, palestra e ushtrimeve të forcës, palestra e aerobisë, parkimi etj. Konstatohet se në hyrje të ambienteve të Hotel "*The Plaza Tirana sh.a.*" janë vendosur tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) sipas modelit standard të miratuar nga Zyra e Komisionerit. Koha e ruajtjes së të dhënave imazhe-video në sistemin e video-vëzhgimit (CCTV) është në përputhje me Udhëzimin nr. 3/2010 të Komisionerit "*Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*".
6. Nga verifikimi i dosjeve të personelit (administruar nga Burimet Njerëzore) u konstatua se për subjektet e të dhënave "*punonjës*" mblidhet e dhëna sensitive "*grupi i gjakut*".
7. Kontrolluesi disponon procedura të shkruara për tërheqjen e dosjes me dokumentat origjinale të punëmarrësve.
8. Kontrolluesi disponon Kod Etike dhe manual trajnues për punonjësit e rinj.
9. Kontrolluesi disponon formularin "*Forma e pakënaqësisë së klientit*" nëpërmjet të cilit i mundëson të drejtën e ankimit subjekteve të të dhënave "*klientë*".
10. Kontrolluesi ka vendosur politikat e privatësisë në portalin zyrtar <http://www.plazatirana.com>. Informacioni i publikuar nuk mundësohet në gjuhën shqipe dhe nuk bazohet në Ligjin Nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Pas konstatimeve të mësipërme rezulton se:

1. Mbikëqyrja nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (CCTV) të ambienteve si palestra e ushtrimeve të forcës, palestra e aerobisë, korridori i SPA-së dhe ambientet jashtë perimetrit të objektit në të cilin kontrolluesi ushtron aktivitetin, referuar pikës së pestë të konstatimeve, përbën shkelje administrative të neneve 5 dhe 6 të ligjit si dhe



Udhëzimit nr. 3/2010 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”.

Një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është sistemi i video-surveimit (CCTV). Kontrolluesi, nëpërmjet këtij mjeti përpunon të dhëna “imazhe-video” të subjekteve të të dhënave “klientë” dhe “punëmarrës”.

Të dhënat e ruajtura në sistemin e video survejimit si “imazhe” apo “video”, janë të dhëna personale për arsye se një individ mund të identifikohet drejtpërdrejtë apo tërthorazi në bazë të këtyre regjistrimeve. Një individ është i identifikueshëm, nëse imazhi në të cilën ai është regjistruar zbulon shenjat e tij dalluese dhe mundëson identifikimin e plotë të tij kur këto karakteristika krahasohen me të dhëna të tjera në dispozicion.

Përpunimi i të dhënave personale me anë të një sistemi video survejimit është i ligjshëm:

- a. për përmbushjen e detyrave të përcaktuara me ligj të veçantë. Në këto raste është e nevojshme që të respektohen dispozitat e ligjit në fjalë;
  - b. me pëlqimin e subjektit të të dhënave, por praktikisht kjo është e mundshme vetëm në raste shumë të kufizuara, atëherë kur identifikimi i një grup personash që janë brenda zonës së kamerës bëhet në mënyrë të qartë;
  - c. pa pëlqimin e subjektit por gjithnjë duke respektuar kriteret e përcaktuara në nenin 6 të Ligjit nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i përditësuar.
2. Mbledhja dhe arshivimi i të dhënës sensitive “grup gjaku” për subjektet e të dhënave “punëmarrës”, referuar pikës gjashtë të konstatimeve, përbën shkelje administrative të neneve 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, pasi, duke parë llojin e aktivitetit që ushtron kontrolluesi, mbledhja e një të dhëne të tillë është e panevojshme.
3. Mungesa e Politikës së Privatësisë në portalin zyrtar të kontrolluesit, referuar pikës 10 të konstatimeve, përbën shkelje administrative të nenit 18 të Ligjit Nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar:
- “1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit...”
- Çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale dhe pavarësisht nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet portalit online në internet, ka detyrim që të publikojë “Politikat e Privatësisë”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash, realizohet nëpërmjet portalit zyrtar të kontrolluesit. Publikimi i “Politikave të Privatësisë” përmbush më së miri qëllimin që ka neni 18 i Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar. Politikat e privatësisë duhet të bazohen në legjislacionin shqiptar dhe gjuhën zyrtare shqipe.



Faktet e mësipërme përbëjnë shkelje të dispozitave 5, 6, 7 dhe 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3/2010 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” por nisur nga fakti që kontrolluesi u tregua bashkëpunues me grupin e kontrollit si dhe gatishmërinë e treguar për përmbushjen e menjëhershme të konstatimeve, Zyra e Komisionerit vlerëson se dalja me akt rekomandues plotëson më së miri përfundimin e këtij kontrolli.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 5, 6, 7, 18, 29, 30, 31/1 gërma a/1 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

### REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të neneve 5, 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi Hotel “The Plaza Tirana sh.a.”:
  - a. Të ndalojë përpunimin e të dhënave “imazhe-video” dhe mbikëqyrjen nëpërmjet sistemit të video-surveimit (CCTV), të ambienteve të tilla si palestra e ushtrimeve të forcës, palestra e aerobisë, korridori i SPA-së dhe ambienteve private dhe publike të cilat nuk janë objekt i veprimtarisë së aktivitetit të vet;
  - b. Të ndalojë mbledhjen e të dhënave sensitive të panevojshme për subjektet “punëmarrës”;
2. Në zbatim të neneve 5, 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi Hotel “The Plaza Tirana sh.a.”:
  - a. Të shkatërrojë të dhënat “imazhe-video” të grumbulluara nga sistemi i video-surveimit (CCTV), në zbatim të pikës së parë gërma “a” të këtij Rekomandimi;
  - b. Të shkatërrojë të dhënat sensitive të mbledhura për subjektet “punëmarrës”, në zbatim të pikës së parë gërma “b” të këtij Rekomandimi;
3. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi Hotel “The Plaza Tirana sh.a.” të hartojë dhe publikojë politikat e privatësisë në portalin zyrtar <http://www.plazatirana.com>, bazuar në legjislacionin shqiptar dhe gjuhën shqipe.
4. Kontrolluesi Hotel “The Plaza Tirana sh.a.” të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në këtë Rekomandim, brenda afatit 15 ditor nga momenti i marrjes dijani. Përmbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi Hotel “The Plaza Tirana sh.a.” përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
5. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i

ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 19.04.2018

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**

